




VOKSHI & LATA

LAW FIRM

NGA **KRIZA** NË MUNDËSI

Udhëzues për Bizneset mbi Procedurën
e Falimentimit





VOKSHI & LATA

LAW FIRM



PREZANTIM

Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” është e specializuar në ofrimin e këshillave ligjore në fushën e të drejtës komerciale. Shërbimet tona ligjore për klientët vendor dhe ndërkombëtar përfshijnë të gjitha proceset e nevojshme nëpër të cilat kalojnë një biznes nga këshillimi në lidhjet e kontratave, çështjet e strukturës së biznesit e deri tek përfaqësimi në gjykata dhe në arbitrazh. Me eksperiencë të gjatë në tregun vendor dhe bashkëpunime me firma ndërkombëtare të avokatisë, “Vokshi & Lata” kombinon njohuritë lokale me standardet ndërkombëtare në ofrimin e shërbimeve ligjore.

Autori Albin Xhemaili është avokat i profilizuar dhe me përvojë në të drejtën komerciale, me fokus të veçantë në kontrata dhe falimentim. Ai ka kontribuar në hartimin e kontratave, ofrimin e opinioneve ligjore për përputhshmërinë me rregullat ligjore, si dhe përfaqësimin e klientëve kom- bëtarë dhe ndërkombëtarë në çështjet e tyre tregtare.

© 2025 Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata”. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Riprodhimi, shpërndarja apo përdorimi i këtij materiali, në tërësi apo pjesërisht, ndalohet pa lejen paraprake të autorit ose të firmës. Ky dokument mbrohet nga ligji për të drejtën e autorit dhe përfaqëson pronën intelektuale të Shoqërisë së Avokatëve “Vokshi & Lata”.

Ky udhëzues është përgatitur me qëllim informimi të përgjithshëm dhe nuk përbën këshillë juridike të personalizuar. Përmbajtja e tij nuk krijon dhe nuk nënkupton ndonjë marrëdhënie avokat-klient me Shoqërinë e Avokatëve “Vokshi & Lata” apo me autorin. Lexuesit këshillohen që, para se të marrin ndonjë veprim ligjor apo të ndërmarrin ndonjë vendim të rëndësishëm biznesor, të kërkojnë këshillë të drejtpërdrejtë nga një profesionist juridik i licencuar. Shoqëria nuk mban përgjegjësi për ndonjë pasojë që mund të rezultojë nga përdorimi i këtij udhëzuesi pa këshillim të mëtijmë profesional.

TABELA E PËRMBAJTJES

PREZANTIM	3
TABELA E PËRMBAJTJES	4
HYRJE	5
I. ÇKA ËSHTË FALIMENTIMI?	6
II. TRAJTIMI LIGJOR DHE GJYQËSOR I FALIMENTIMIT	7
III. PJESEMARRËSIT NË PROCEDURË	8
IV. REZULTATET E FALIMENTIMIT	9
IV.1. Riorganizimi	9
Shembulli A: Riorganizimi në praktikë	10
IV.2. Likuidimi	11
Shembulli B: Likuidimi në praktikë	12
V. FILLIMI I PROCEDURËS DHE EFEKTET JURIDIKE	13
Shembulli C: Inicimi i procedurës nga kreditori	14
VI. KËRKESAT E KREDITORËVE DHE REALIZIMI I TYRE	16
VII. LIRIMI NGA BORXHET	18
VII.1. Lirimi në procedurë të riorganizimit	18
VII.2. Lirimi në procedurë të likuidimit	18
VIII. RËNDËSIA E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT	19
IX. KONKLuzion	21

HYRJE



Në bisedat e përditshme, termi “*falimentim*” shpesh përdoret gabimisht për të përshkruar një biznes që po kalon thjesht vështirësi financiare, si mbyllja e njërive apo zvogëlimi i kapaciteteve. Megjithatë, një afarizëm i vështirësuar nuk është njësoj me falimentimin; fitimi i këtij statusi kërkon zhvillimin e një procedure të rregullt ligjore.

E rëndësishme është të theksohet se procedura e falimentimit nuk nënkupton gjithmonë një fund negativ. Përkundrazi, në shumë raste, ky proces mund t’i japë një biznesi mundësinë për një fillim të ri apo një ristrukturim të suksesshëm të operacioneve financiare. Në këto situata, falimentimi nuk është fundi i biznesit. Edhe kur shënon fundin, ai mbetet mënyra më e përshtatshme dhe më dinjitoze për të përmbyllur detyrimet e biznesit në vështirësi.

Ky udhëzues ofron një vështrim mbi falimentimin nga perspektiva juridike, duke shqyrtuar kuptimin, rregullimin e tij sipas legjislacionit vendor, dhe rëndësinë praktike për bizneset në vështirësi. Gjithashtu përfshin edhe shembuj praktikë për të ilustruar se si ky proces mund të përdoret për të adresuar sfidat financiare në mënyrë efektive.


I. ÇKA ËSHTË FALIMENTIMI?

Bizneset mund të jenë të fushave të ndryshme dhe të dallojnë në shumë aspekte, por të gjitha kanë një qëllim të përbashkët: fitimin. Gjatë veprimtarisë afariste të tyre, bizneset shpesh përballen me situata të pafavorshme ekonomike, që nganjëherë çojnë në vështirësi financiare, e në rastet më të rënda, në insolvencë. Në një gjendje të tillë, asetet e biznesit humbasin vlerën e tyre, e të hyrat që realizojnë nuk janë më të mjaftueshme për të mbuluar as borxhet.

Në raste të tilla, bizneset interesohen të kërkojnë një zgjidhje lidhur me detyrimet e veta, të cilat nuk po kanë mundësi t'i përmbushin. Pikërisht për situata si kjo, në të gjitha sistemet juridike bashkëkohore është paraparë rregullativa ligjore e falimentimit.

Falimentimi është një proces ligjor i cili iu mundëson bizneseve që, në një mënyrë apo tjetrën, të lirohen nga detyrimet të cilat nuk kanë mundësi t'i përmbushin. Ky proces iu ofron një zgjidhje bizneseve të ndodhura në një situatë të pamundësisë pague, dhe kjo nëpërmjet ristrukturimit të borxheve, që kompanisë i mundëson rifillim të freskët të veprimtarisë, apo nëpërmjet shitjes së aseteve dhe përmbushjes së detyrimeve nga vlera e atyre aseteve të shitura. Se cila prej këtyre alternativave do të ndiqet, vlerësohet prej rastit në rast, duke marrë për bazë rrethanat konkrete, si dhe përcaktimet ligjore.

Si i tillë, falimentimi pra nuk është vetëm në interes të biznesit që ndodhet në vështirësi financiare, por edhe të personave të cilët kanë kërkesa ndaj biznesit insolvent, të cilët përmes falimentimit mund të shpresojnë për një rikuperim të pjesshëm ose të plotë të kërkesave të tyre.



II. TRAJTIMI LIGJOR DHE GJYQËSOR I FALIMENTIMIT


Në përgjithësi, rregullativa e falimentimit është një pjesë e rëndësishme e infrastrukturës ligjore dhe ekonomike të një vendi. Një kornizë e tillë ligjore e bën sistemin financiar më të drejtë, transparent dhe të qëndrueshëm. Në qoftë se ndërmarrësit janë të vetëdijshëm se e kanë një rrjetë sigurie siç është falimentimi, ata do të jenë më të gatshëm që të ndërmarrin riskun e nevojshëm për themelimin dhe zgjerimin e bizneseve, gjë që në fund ndikon pozitivisht në parametrat e ekonomisë kombëtare.

Republika e Kosovës e ka të rregulluar procedurën e falimentimit me Ligjin Nr. 08/L-256 për Falimentimin (këtu e tutje referuar si: “LF”), i cili ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2024.

Ky ligj është i harmonizuar me ligjet ekuivalente të shteteve të Unionit Evropian dhe brenda vetes përmban dispozita të cilat në mënyrë shteruese rregullojnë procesin e falimentimit, që nga iniciimi e deri te përfundimi i tij.

Si proces ligjor, me rastet e falimentimit administron ekskluzivisht gjykata. Sipas dispozitave të LF-së, kompetencë për gjykimin e çështjeve të falimentimit ka Gjykata Komerciale e Kosovës, me të dy shkallët e saj.

Ndaj vendimeve të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankesa, ndërsa mjetet e jashtëzakonshme nuk lejohen në procedurë të falimentimit.



III. PJESËMARRËSIT NË PROCEDURË

Në një proces falimentimi marrin pjesë këta persona:

1. Debitori: ky është biznesi i cili ka detyrime ndaj të tjerëve, e të cilat nuk po arrin t'i përmbushë – pra, është në pamundësi pagese. Debitori është subjekti ndaj të cilit zhvillohet procedura e falimentimit dhe njëherësh, shkak për një procedurë e tillë është iniciuar. Dispozitat e LF-së përcaktojnë se debitor i falimentimit mund të jetë vetëm shoqëria tregtare, e definuar sipas ligjit të aplikueshëm për shoqëri tregtare.

2. Kreditori: është personi i cili ka të paktën një kërkesë ndaj debitorit. Si kreditorë paraqiten personat fizikë, juridikë dhe entitetet tjera, të cilët kanë një a më shumë kërkesa ndaj debitorit të falimentimit. LF-ja parasheh se në anën e kreditorit të falimentimit, varësisht prej rastit, mund të paraqiten një apo më shumë persona. Statusi i kreditorit mund të fitohet në fillim, me rastin e inicimit të procedurës, apo më vonë, mirëpo deri në një fazë të caktuar.

3. Administratori i falimentimit, apo përfaqësuesi i pasurisë së falimentimit: person i licencuar nga organi kompetent, i cili pasi të caktohet nga ana e gjykatës për ta ushtruar këtë rol, administron me tërë pasurinë e debitorit, nga disponimi i zakonshëm me qëllim të ruajtjes së vlerës, e deri në shitjen dhe shpërndarjen e saj të kreditorët. Administratori mund të padisë dhe të jetë i paditur në emër të kësaj pasurie, si dhe kryen një numër të konsiderueshëm të funksioneve, ashtu siç janë përcaktuar me dispozitat e LF-së. Pra, pas caktimit, administratori ka rol ekzekutiv në kompaninë debitore, që do të thotë se i njëjti e merr në udhëheqje atë kompani dhe ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme në kuptim të menaxhimit të saj përgjatë periudhës së tranzicionit, deri në likuidim të tërësishëm të aseteve, apo në raste të caktuara – deri në përfundim të ristrukturimit të debitorit.

4. Monitoruesi: ky është një person i emëruar nga gjykata nga radhët e administratorëve të falimentimit për të mbikëqyrur procesin e riorganizimit tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (këtu e tutje referuar si: “NVM”). Roli i tij është të ndihmojë debitorin në hartimin e planit të riorganizimit dhe të mbikëqyrë zbatimin e tij. Por, kjo mbikëqyrje nuk është e karakterit hierarkik, pasi që monitoruesi nuk ka rol ekzekutiv në kompaninë debitore, mirëpo vetëm rol konsultativ. Ai raporton në gjykatë mbi progresin dhe jep rekomandime për përmirësime. Kohëzgjatja e angazhimit të tij përfundon me mbylljen e procesit të riorganizimit.



IV. REZULTATET E FALIMENTIMIT

Në fillim të këtij udhëzuesi, kur u definua falimentimi, u tha se kjo procedurë mund të zhvillohet në dy drejtime, varësisht prej rrethanave të rastit, përkatësisht si proces që mundëson riorganizimin e debitorit, apo proces që për rezultat e ka shitjen e aseteve të debitorit, përkatësisht likuidimin. Këto dy drejtime të falimentimit do të analizohen në vijim.

IV.1. Riorganizimi

Riorganizimi është një procedurë gjyqësore në kuadër të procedurës së falimentimit, nëpërmjet të cilës debitorit të falimentimit i mundësohet ristrukturimi i aktivitetit të tij afarist, me qëllim për të arritur në një situatë më të qëndrueshme financiare. Ky ristrukturim bëhet përmes rishikimit dhe rindrejtimit të kostove, si dhe mënyrave të prodhimit të produkteve apo ofrimit të shërbimeve.

Qëllimi kryesor i këtij procesi është të sigurojë që një kompani e cila mund të ketë vështirësi financiare, të ndjekë rrugën e riorganizimit dhe të shpëtojë nga likuidimi. Kjo bëhet e mundur pasi që procesi i riorganizimit i jep debitorit një periudhë kohe të caktuar për të rikthyer pozitën e favorshme financiare, që do të mundësonte përmbushjen e detyrimeve ndaj kreditorëve të tij. Pra, riorganizimi mund të ndihmojë në mbajtjen ‘gjallë’ të kompanisë në biznes, si dhe në ruajtjen e vendeve të punës.

Riorganizimi si procedurë gjyqësore inicohet vetëm me kërkesën e debitorit. Sipas kësaj, i bie që përzgjedhja e kësaj procedure është tërësisht në vullnetin e debitorit. Megjithatë, ligji parasheh një rrethanë kur riorganizimi është i detyrueshëm për debitorin. Këtu kemi të bëjmë me rastet kur debitori i falimentimit është NVM, kur rasti çdoherë trajtohet si riorganizim.

Sidoqoftë, riorganizimi inicohet pra nga debitori, i cili përpilon edhe planin e riorganizimit. Ky plan përmban një analizë të detajuar financiare mbi hapat që debitori zotohet të ndërmarrë për të përmirësuar veprimtarinë e tij afariste, me qëllim arritjen e një gjendjeje solvente, ku pastaj përmbushja e detyrimeve ndaj kreditorëve do të bëhet e mundur. Duke qenë se detyrimet nuk po realizohen aktualisht, plani i riorganizimit zakonisht përfshin edhe shtyrjen e afateve të pagesës së tyre deri në kohën kur debitori parashikon rimëkëmbjen financiare.

Pasi ky plan paraqitet në gjykatë, i njëjti i nënshtrohet procesit të votimit nga ana e kreditorëve të falimentimit, të cilët votën e tyre e japin varësisht prej vlerësimit që kanë për planin e riorganizimit të ofruar nga debitori. E në fund, plani i riorganizimit i nënshtrohet edhe miratimit nga ana e gjykatës.

Në procedurë të riorganizimit, debitori parimisht mbetet në posedim të kompanisë së tij, që do të thotë se i njëjti vazhdon të menaxhojë me kompaninë si çdoherë tjetër, përveç se tani duhet që politikat afariste të zhvillojë në pajtim me planin e miratuar të riorganizimit.

Qëllimi i kësaj procedure është që debitori i falimentimit të rikthehet në gjendje financiare stabile, ku do të jetë në gjendje që t'i përmbushë detyrimet që i ka ndaj kreditorëve, proces ky i rregulluar me planin e riorganizimit. Pasi plani të përmbushet në tërësi, gjykata do ta mbyllë rastin e riorganizimit dhe kompania debitore do të kthehet në kontroll të plotë të drejtuesit të saj, për ta zhvilluar aktivitetin afarist pa pengesa.

Në të kundërtën, po që se plani i riorganizimit nuk përmbushet nga debitori, që për shkak ka humbjen e vlerës së pasurisë së falimentimit, gjykata mund të urdhërojë shndërrimin e procedurës së riorganizimit në likuidim.

Shembulli A: Riorganizimi në Praktikë

Një kompani teknologjike prezantoi në fillim të vitit 2017 një produkt softuerik inovativ që mundëson menaxhimin e sigurisë së rrjetit brenda zyrave. Fillimisht, produkti pati një sukses të jashtëzakonshëm, duke siguruar shitje të larta brenda dhe jashtë vendit. Me qëllim të përshtatjes me kërkesën në rritje, kompania mori disa kredi bankare në vlera të larta, për të rritur kapacitetet e saj.

Megjithatë, në mars të vitit 2020, për shkak të përhapjes së pandemisë “Covid-19”, shtetet në tërë botën aplikuan masa të rrepta mbrojtëse, përfshirë ndalimin e punës nëpër zyre. Për pasojë, kërkesa për produktin ra pothuajse tërësisht, duke e lënë kompaninë pa të ardhura për të përmbushur detyrimet financiare. Bankat kreditore filluan procedurat përmbareme për të rikuperuar borxhet. Meqenëse kompania nuk kishte mjete monetare, ajo rrezikonte që shkak i këtyre procedurave, të humbte asetet e saj.

Pronarët e kompanisë ishin në dijeni se produkti i tyre kishte perspektive të lartë të shitjes në të ardhmen, po sa gjendja të kthehej në normalitet. Megjithatë, të shqetësuar për gjendjen momentale, ata kërkuan këshilla ligjore. Avokati sugjeroi fillimin e procedurës së falimentimit me propozim për riorganizim, ku i njoftoi lidhur me mundësinë e përpilimit të planit të riorganizimit, i cili do të parashikonte shtyrjen e afateve të pagesës së kërkesave të arritura, për një periudhë prej një viti, deri në largimin e masave dhe rifillimin e punës në zyre, gjë që patjetër do të kthente në normalitet kërkesën për produktin.

Pas konsultimeve, votimeve dhe miratimit nga gjykata, plani i riorganizimit i përpiluar nga kompania hyri në fuqi. Pasi masat filluan të lehtësoheshin, kompania rifilloi shitjet, duke rikuperuar të ardhurat dhe duke shlyer borxhet ndaj kreditorëve sipas afateve të dakorduara në plan. Me përmbushjen e suksesshme të planit, gjykata e mbylli procedurën e riorganizimit dhe kompania vazhdoi aktivitetin afarist normal ashtu siç ishte para krizës.

IV.2. Likuidimi

Sipas ligjit tonë të falimentimit, likuidimi është një proces i cili mundëson shitjen e aseteve të debitorit dhe pastaj shpërndarjen e pasurisë së falimentimit të krijuar nga ajo shitje, te kreditorët e falimentimit, në mënyrë që të përmbushen detyrimet ndaj tyre.

Përderisa te riorganizimi qëllimi ishte rimëkëmbja financiare e debitorit, në rastet e likuidimit qëllimi është përmbushja e kërkesave të kreditorëve nëpërmjet shitjes dhe shpërndarjes së aseteve të debitorit.

Edhe procedura e likuidimit hapet me vendim të gjykatës, mirëpo për dallim nga ajo e riorganizimit, këtu caktohet një administrator falimentimi, i cili e udhëheqë komplet procedurën e likuidimit, deri në shitje të aseteve – normalisht, me leje të kohëpaskohshme të gjykatës, kur këtë e kërkon ligji.

Administratori i falimentimit e merr në udhëheqje kompaninë në falimentim (debitorin), me ç'rast ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për të identifikuar dhe rritur pasurinë e falimentimit, e cila në fund do të shitet dhe shpërndahet te kreditorët, sipas rendit dhe prioritetit të përcaktuar me ligj. Kështu, administratori i falimentimit e udhëheqë edhe procedurën e shitjes së aseteve, edhe atë të shpërndarjes së pasurisë së falimentimit, të krijuar nga shitja.

Procesi i likuidimit konsiderohet i përfunduar me rastin e shpërndarjes së të gjithë pasurisë së falimentimit të krijuar nga shitja e aseteve të debitorit. Duke qenë pra se qëllimi i likuidimit është që të përmbushen kërkesat e kreditorëve nëpërmjet shitjes së aseteve të debitorit, atëherë rrjedhimisht i bie se kjo procedurë përfundon pas kryerjes së suksesshme të këtij procesi.

Natyrisht edhe nga përkufizimet si më lart ka përjashtime. Kjo pasi në disa raste nuk është e nevojshme që e gjithë pasuria e debitorit të shpërndahet, për shkak se kërkesat e kreditorëve mund të përmbushen edhe me shpërndarjen e pjesshme të saj. Ndërsa në raste tjera, që në fakt përbën shumicën e rasteve, vlera e aseteve nuk është e mjaftueshme për të përmbushur plotësisht kërkesat e kreditorëve.

Pavarësisht nga rastet, në momentin kur administratori i falimentimit, me mjetet monetare të krijuara nga shitja e aseteve të debitorit, përmbush kërkesat e kreditorëve në masën e mundur dhe sipas prioritetit ligjor, procedura e falimentimit përmes likuidimit përfundon. Me këtë rast, debitori i falimentimit shlyhet nga regjistri i Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, dhe i tërë aktiviteti afarist i tij konsiderohet i përmbyllur.

Dispozitat e LF-së lejojnë shndërrimin edhe nga likuidimi në riorganizim, po që se arsyeshëm mund të konstatohet se në atë mënyrë kreditorët do të realizonin kërkesat e tyre në masë më të madhe.

Pra, edhe në rastet kur debitori ka kërkuar likuidimin, riorganizimi mund të konsiderohet më i favorshëm nëse asetet e debitorit nuk janë të mjaftueshme për të përmbushur kënaqshëm kërkesat e kreditorëve, ndërsa në anën tjetër ekziston një perspektivë e qëndrueshme për rritje të ardhshme të të hyrave të debitorit, me ç'rast riorganizimi mund të krijojë mundësi për një kthim më të lartë dhe më të drejtë të borxheve.

Shembulli B: Likuidimi në praktikë

Një kompani ndërtimi, e cila për disa vite kishte pasur prani të fortë në tregun vendor, hyri në vështirësi të mëdha financiare pas rënies së tregut të ndërtimit dhe anulimit të disa projekteve të rëndësishme. Kompania nuk arrinte të gjeneronte të hyra, dhe për pasojë, detyrimet e saj financiare u grumbulluan deri në atë masë sa u bën të papërballueshme.

Kreditorët veçse kishin filluar përpjekjet e tyre për të realizuar kërkesat ndaj kompanisë. Kompania nuk dispononte me mjete monetare dhe për shkak të rënies së tregut, as asetet e saj – si toka, objektet apo mjetet ndërtimore – nuk ishin të mjaftueshme për të përmbushur të gjitha detyrimet ndaj kreditorëve. Për më tepër, kompania nuk kishte ndonjë perspektivë për përmirësimin e gjendjes financiare që do t'i mundësonte përballimin e detyrimeve në periudhë afatgjate.

Në këto rrethana, pronarët e kompanisë kërkuan ndihmë juridike dhe u këshilluan që të fillojnë procedurën e falimentimit me synim për likuidim.

Gjykata miratoi fillimin e procedurës së likuidimit, duke caktuar një administrator falimentimi për të udhëhequr procesin. Administratori identifikoi asetet e kompanisë, përfshirë tokën dhe ndërtesat e papërfunduara, dhe filloi procesin e shitjes së tyre në mënyrë të organizuar dhe transparente. Të ardhurat nga shitja e këtyre aseteve iu shpërndanë kreditorëve sipas prioritetit të përcaktuar me ligj, duke mundësuar përmbushjen e pjesshme të detyrimeve ndaj tyre.

Në përfundim, procedura e likuidimit garantoj që kompania të shuhej në mënyrë të rregullt nga regjistri i bizneseve, duke i dhënë fund përgjegjësisë financiare të mbetura të saj.

V. FILLIMI I PROCEDURËS DHE EFEKTET JURIDIKE

Procedura e falimentimit sipas dispozitave të LF-së, mund të fillojë në dy mënyra: (i) sipas kërkesës së debitorit për fillim të procedurës (inicimi vullnetar); dhe (ii) sipas kërkesës së kreditorëve për fillim të procedurës (inicimi jo-vullnetar).

1. Inicimi vullnetar: nënkupton paraqitjen e kërkesës së debitorit për riorganizim apo për likuidim pranë gjykatës. Në këtë rast, procedura e falimentimit pranë gjykatës së falimentimit fillon me propozimin e vetë debitorit për riorganizim apo likuidim. Duke qenë se ky propozim parashtrohet prej debitorit i cili pretendon se është në paaftësi paguese apo afër kësaj gjendjeje, atëherë i njëjti së bashku me kërkesën duhet të paraqesë edhe dëshmitë e nevojshme, përkatësisht dokumentet financiare adekuate që vërtetojnë një pretendim të tillë.

2. Inicimi jo-vullnetar: është situata kur një apo më shumë paraqesin pranë gjykatës së falimentimit kërkesën për iniciimin e procedurës së falimentimit ndaj një debitori. Për iniciimin e procedurës së falimentimit nga kreditorët, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme, në varësi nëse kërkesa paraqitet nga një kreditor ose nga më shumë kreditorë:

Për një kreditor:

- i. Debitori nuk ka paguar të paktën një detyrim për më shumë se 90 ditë.
- ii. Totali i detyrimit të jetë të paktën 30,000 Euro.
- iii. Detyrimi të jetë pa kushte dhe të mos jetë në procedurë kontestimore në gjykatë ose arbitrazh.
- iv. Kreditori nuk ka arritur ta arkëtojë borxhin përmes përmbarimit ose procedurave tjera.

Për dy ose më shumë kreditorë:

- i. Debitori nuk ka paguar të paktën dy detyrime, secili me vonesë prej mbi 90 ditësh.
- ii. Vlera e secilit detyrim të jetë të paktën 5,000 Euro.
- iii. Çdo detyrim të jetë pa kushte dhe të mos jetë në procedurë kontestimore.
- iv. Kreditorët nuk kanë arritur ta arkëtojnë borxhin përmes përmbarimit ose procedurave tjera.
- v. Debitori përgjithësisht nuk po përmbush borxhet pas afatit të pagesës, me një total të papaguar mbi 7,000 Euro.

Shembulli C: Inicimi i procedurës nga kreditori

Një kompani prodhuese, për të financuar projektet e saj, ka marrë kredi nga dy banka: Banka A dhe Banka B. Secila bankë e ka të siguruar kredinë në të njëjtat asete të kompanisë, duke vendosur hipotekë mbi të njëjtën pasuri të paluajtshme.

Banka A ka regjistruar e para hipotekën, ndërsa Banka B e dyta.

Për shkak të gjendjes së renduar financiare të kompanisë, ajo nuk ka arritur të përmbushë detyrimet ndaj asnjërës bankë. Banka B, duke qenë e vetëdijshme për prioritetin e Bankës A dhe për faktin se borxhi ndaj saj është shumë i lartë, shqetësohet se nuk do të ketë mundësi të realizojë kërkesën e saj as pjesërisht në rast përmbarimi.

Në këto rrethana, Banka B vendos të kërkojë ndihmë juridike dhe, pas këshillave të avokatëve, zgjedh të iniciojë procedurën e falimentimit ndaj kompanisë në gjykatë, në vend që të vazhdojë me përmbarimin. Kjo pasi një zgjidhje e tillë bën të mundur që Banka B të trajtohet si kreditor në të njëjtin rang me Bankën A, pasi të dyja kanë kërkesa të të njëjtës kategori.

Në përfundim të procesit, administratori i falimentimit shpërndau mjetet e krijuara nga shitja e aseteve të kompanisë në mënyrë proporcionale për të dy bankat, duke siguruar që si Banka A ashtu edhe Banka B të realizojnë pjesërisht kërkesat e tyre. Ky proces shmangu përjashtimin e Bankës B nga realizimi i kërkesës së saj, gjë që do të ishte e pashmangshme nëse procedura do të kishte vazhduar përmes përmbarimit individual.

Në të dy rastet, po që se gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore adekuate, vendosë për iniciimin e procedurës së falimentimit (hapjen e rastit). Ky vendim i gjykatës ka pasoja juridike të menjëhershme, siç janë:

1. Maturimi i kërkesave: me hapjen e procedurës së falimentimit, të gjitha kërkesat e kreditorëve, të cilat janë të paarritura për pagesë deri në atë moment, bëhen të arritura sipas ligjit. Kjo do të thotë që, pa marrë parasysh datën e paracaktuar të pagesës, të gjitha detyrimet e debitorit konsiderohen të arritura me hapjen e procedurës, duke mundësuar kështu trajtimin e tyre në procesin e falimentimit.


2. Krijimi i pasurisë së falimentimit: hapja e procesit të falimentimit ka për pasojë edhe krijimin e pasurisë së falimentimit, e cila përbëhet nga të gjitha pasuritë e luajtshme e të paluajtshme të debitorit, si dhe interesat e kërkesat në favor të debitorit, ekzistuese në kohën e hapjes së rastit. Kjo pasuri mund të shtohet pas veprimeve ligjore adekuate gjatë zhvillimit të procedurës.

3. Moratoriumi: vendimi i gjykatës për hapjen e falimentimit vendos edhe moratoriumin mbi debitorin e falimentimit dhe pasuritë e tij. Moratoriumi ndalon të gjitha proceset gjyqësore, administrative, përmbarimet, si dhe çdo lloj procedure tjetër e drejtuar kundër aktivitetit afarist të debitorit apo pasurive të tij. Kjo ndalesë vlen për rastet aktive në momentin e hapjes së rastit, si dhe për ato që iniciohen më pas.

4. Shkarkimi i debitorit nga kontrolli i pasurisë: debitori humbet kontrollin mbi pasurinë e falimentimit, e cila kalon nën mbikëqyrjen e plotë të administratorit të falimentimit për menaxhim, shitje dhe shpërndarje.

5. Jurisdiksioni ekskluziv i gjykatës: gjykata e falimentimit merr kontrollin e plotë dhe ekskluziv mbi debitorin dhe pasurinë e falimentimit, duke i dhënë asaj autoritetin për të vendosur mbi të gjitha aspektet e procesit.

Këto pasoja juridike paraqiten pra sipas vet ligjit me t'u iniciuar procedura e falimentimit me vendim të gjykatës. Secila prej tyre është e domosdoshme në mënyrë që kjo procedurë të zhvillohet pa pengesa sipas përcaktimeve ligjore, duke u arritur në këtë mënyrë qëllimi i saj.



VI. KËRKESAT E KREDITORËVE DHE REALIZIMI I TYRE

U tha se procedura e falimentimit është e favorshme edhe për kreditorët, pasi në këtë mënyrë atyre do t'iu mundësohet realizimi i pjesshëm, apo edhe i plotë i kërkesave të tyre. Që të gjithë kreditorët në proces të falimentimit janë aty për këtë qëllim – pra, realizimin e kërkesave të tyre. Mirëpo kreditorët shpeshherë kanë kërkesa të ndryshme nga njeri-tjetri, si për nga lloji, ashtu edhe nga lartësia. Prandaj, ligji parasheh rregulla të veçanta në këtë aspekt, në mënyrë që të përcaktojë prioritetin e trajtimit të tyre në mënyrë të drejtë dhe të strukturuar.

Kreditorët në një procedurë të falimentimit, për t'u kualifikuar si të tillë, fillimisht duhet të dëshmojnë kërkesën e tyre nëpërmjet provave përkatëse. Secili person që pretendon të hyjë në listën e kreditorëve, sipas dispozitave të LF-së, duhet të dorëzojë dokumentacion përkatës me qëllim të vërtetimit të ekzistencës, e pastaj të lartësisë së kërkesës së tij. Këtu përfshihen faturat, kontratat, vendimet gjyqësore, si dhe dokumente tjera të cilat dëshmojnë burimin dhe lartësinë e kërkesës.

Pas pranimit të kërkesave bashkë me dokumentacionin përcjellës, administratori i falimentimit publikon listën e kreditorëve, ndaj të cilës listë është i lejuar kundërshtimi në gjykatë. E pas përfundimit të procesit të verifikimit të kreditorëve, të njëjtit kualifikohen për pjesëmarrje në shpërndarjen e pasurisë së falimentimit, në bazë të prioritetit të tyre të përcaktuar nga ligji.

Dispozitat e LF-së i klasifikojnë kreditorët sipas ndarjes dhe renditjes në vijim:

1. Kreditorët e siguruar: janë bartësit e kërkesave të siguruara me peng apo hipotekë mbi pasurinë e falimentimit. Kërkesat e tilla konsiderohen të siguruara deri në vlerën e pengut ose hipotekës. Nëse vlera e pasurisë së ngarkuar nuk mbulon plotësisht kërkesën, pjesa e mbetur trajtohet si kërkesë e pasiguruar. Kreditorët e siguruar kanë përparësinë e parë në realizimin e kërkesave të tyre përmes shitjes së pasurisë së falimentimit.

2. Kreditorët e pasiguruar: janë kreditorë që kanë kërkesa të rëndomta në drejtim të debitorit të falimentimit. Brenda kësaj kategorie ekziston një rend prioritar në shpërndarje. Ky rend është si në vijim:

i) *shpenzimet administrative të procedurës së falimentimit:* kjo përfshin pagesat për administratorin e falimentimit dhe shpenzimet e tjera të ndërlidhura drejtpërdrejt me procesin;

ii) *kërkesat nga marrëdhënia familjare dhe ato për kompensim të viktimave:* përfshijnë detyrimet e debitorit ndaj anëtarëve të familjes, të cilat burojnë nga dispozitat përkatëse ligjore të familjes, si dhe kërkesat për kompensimin e viktimave, të cilat burojnë nga aktivitetet penale të debitorit;

iii) *kërkesat nga marrëdhënia e punës:* detyrimet ndaj të punësuarve të debitorit për pagat e papaguara dhe përfitimet e tjera që rrjedhin nga marrëdhënia e punës;

iv) *kërkesat tatimore:* këtu përfshihen të gjitha detyrimet tatimore të pashlyera ndaj organeve shtetërore;

v) *kërkesa të tjera të pasiguruara:* përfshihen të gjitha kërkesat e tjera të pasiguruara ndaj debitorit të falimentimit, që nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme.

3. Interesat në ekuitet: janë kërkesat të cilat përmbushen më së voni, përkatësisht me prioritetin më të ultë në rangun e kreditorëve. Kjo kategori përfshin aksionarët, pronarët, e ortakët, të cilët kanë pjesë pronësore në kapitalin e kompanisë debitore.

Në këtë mënyrë, ligji pra përcakton prioritet në realizimin e kërkesave të kreditorëve të falimentimit. Kjo renditje është e rëndësishme për shkak se pasuria e falimentimit shpeshherë nuk është e mjaftueshme për të përmbushur të gjitha kërkesat, prandaj një renditje e mirë në kategorizimin si më sipër, mundëson realizimin më të sigurt të kërkesës së kreditorit. Njëherësh, sa më e ulët të jetë renditja në klasat e kreditorëve, gjasat për realizimin e kërkesës zvogëlohen.

Përderisa rangjet më të larta të kreditorëve kanë prioritet në realizimin e kërkesave në raport me rangjet më të ulëta, ky nuk është rasti me kërkesat e rangut të njëjtë. Brenda një klase të kreditorëve, shpërndarja e pasurisë së falimentimit bëhet në mënyrë proporcionale, sipas parimit pari passu. Në këtë kontekst, edhe po që se pasuria e falimentimit nuk është e mjaftueshme për t'u përmbushur kërkesat e kreditorëve të klasës së njëjtë, ajo pasuri do të shpërndahet te ata kreditorë në mënyrë proporcionale, ku secili kreditor do të realizojë kërkesën e tij në përqindje të njëjtë.



VII. LIRIMI NGA BORXHET

Dispozitat ligjore të falimentimit parashohin edhe institutin e lirimit nga borxhet. Varësisht nëse procedura është zhvilluar si riorganizim apo si likuidim, rëndësia e këtij instituti dallon.

VII.1. Lirimi në procedurë të riorganizimit

Siç u tha më lart në këtë shkrim, me përfundimin e suksesshëm të riorganizimit, debitorit të falimentimit i kthehet në posedim, menaxhim dhe administrim të rregullt kompania e tij. Përfundimi i suksesshëm paraqitet në një rrethanë kur plani i riorganizimit përmbushet në mënyrë të plotë nga debitori i falimentimit. Megjithatë, jo çdoherë plani i riorganizimit përfshin përmbushjen e plotë të detyrimeve të debitorit. Nganjëherë, në këtë plan përcaktohet që vetëm një pjesë e atyre detyrimeve të përmbushet. Në këto rrethana paraqitet nevoja e lirimit të debitorit të riorganizuar nga borxhet e mbetura.

Një nevojë e tillë paraqitet për arsye se kreditorët në proces të falimentimit e kanë realizuar vetëm një pjesë të kërkesës së tyre. Mirëpo pas përfundimit të këtij procesi, ata mund të ndërmarrin hapa në drejtim të realizimit edhe të pjesës së mbetur të kërkesës së tyre. Kjo posaçërisht duke marrë parasysh faktin se tani debitori është rimëkëmbur dhe është kthyer në afarizëm normal. Dispozitat e LF-së për lirimin nga borxhet i parandalojnë këto përpjekje, duke përcaktuar detyrimin e gjykatës që pas përfundimit të procesit, debitorin ta lirojë nga borxhet të cilat kanë ekzistuar deri në momentin e hapjes së procedurës së riorganizimit.

Ky përcaktim ligjor është i rëndësishëm për shkak se ruan qëllimin dhe nevojën e procedurës së falimentimit. Pra, lirimi nga borxhet i mundëson debitorit që të vazhdojë afarimin pas riorganizimit në mënyrë të rregullt dhe të papenguar nga borxhet të cilat veçse janë shqyrtuar në proces të falimentimit.

VII.2. Lirimi në procedurë të likuidimit

Lirimi nga borxhet parashihet edhe në rastet e likuidimit. Megjithatë, për shkak të natyrës së këtij procesi, ky institut këtu paraqitet shumë më i kufizuar, pasi rëndësia e tij është krejtësisht teknike. Kështu, duke qenë se me përfundimin e procedurës së likuidimit, debitori shuhet si kompani, atëherë edhe detyrimet e tij i përcjellë i njëjti fat. Sidoqoftë, lirimi nga borxhet parandalon që një kompani e falimentuar përmes likuidimit të jetë subjekt i kërkesave për realizimin e borxheve të vjetra, e të shqyrtuara paraprakisht në procedurë të falimentimit.

Ndryshe prej riorganizimit, këtu qëllimi i lirimit nga borxhet është parandalimi i kërkesave kundrejt një entiteti të mbyllur, apo ish-pronarëve të tij, si dhe mbrojtja e integritetit dhe qëllimit të procedurës së falimentimit.



VIII. RËNDËSIA E PROCEDURËS SË FALIMENTIMIT

Deri tani, u shpjegua kuptimi dhe rregullimi i procedurës së falimentimit, si dhe u paraqitën elementet e saj përbërëse. Në këto shpjegime, janë ilustruar rrethanat që dëshmojnë rëndësinë e qartë të kësaj procedure, e cila ofron përfitime për të dyja palët e përfshira, si për debitorin ashtu edhe për kreditorin.

Megjithatë, disa biznese mund të shfaqin skepticizëm ndaj këtij procesi, duke konsideruar se shitja e aseteve për mbulimin e detyrimeve mund të realizohet edhe në mënyrë të pavarur ose se kërkesat e tyre mund të përmbushen më mirë përmes procedurave të tjera, si ato gjyqësore apo përmbartimore.

Në këtë pjesë përmbyllëse të këtij udhëzuesi, do të përmbliidhen avantazhet kyçe të procedurës së falimentimit, për të vërtetuar padyshim se ky proces është i vlefshëm, i dobishëm, dhe shpesh i vetmi option për bizneset vendore.

1. Përfitimet për debitorin:

i) Mbrojtja nga kreditorët: me inicimin e procedurës së falimentimit, ndalohen përpjekjet e kreditorëve në drejtim të realizimit të kërkesave të tyre. Në procedurë të likuidimit kjo krijon hapësirë për likuidim të organizuar dhe të mbikëqyrur nga gjykata, ku debitori mbrohet nga kërkesat e pakontrolluara të kreditorëve dhe shmanget kaosi i shitjeve të fragmentuara të aseteve. E në rast të riorganizimit, kjo ndalesë i siguron debitorit kohë dhe hapësirë për të zhvilluar dhe zbatuar një plan riorganizimi, duke mundësuar një rikthim të qëndrueshëm në operim, pa ndërhyrje të jashtme të menjëhershme.

ii) Likuidim efikas dhe i drejtë: procesi i likuidimit udhëhiqet nga një administrator falimentimi që siguron që asetet të shiten me çmim të drejtë dhe në mënyrë transparente.

iii) Riorganizimi dhe fillimi i ri: procedura e falimentimit nuk shënon çdoherë fundin e biznesit. Në raste të caktuara ky proces mund t'iu ofrojë bizneseve mundësinë për riorganizim, ashtu që pas përmbushjes së planit të riorganizimit, të rikthehen në aktivitetin normal biznesor të tyre.

iv) Lirimi nga borxhet: Pas përfundimit të likuidimit, borxhet e parealizuar shlyhen dhe kompania fshihet nga regjistri i bizneseve, që do të thotë që kreditorët nuk mund të kërkojnë më borxhet nga debitori. Ngjashëm, pas përfundimit të riorganizimit, borxhet e mbetura të debitorit mund të shlyhen, duke i dhënë mundësi debitorit të fillojë afarizmin i lirë nga borxhet e vjetra dhe i mbrojtur nga kërkesat e kreditorëve në drejtim të realizimit të tyre.

2. Përfitimet për kreditorin:

i) Realizimi i kërkesës: procedura e falimentimit ofron mundësinë për të realizuar kërkesat në mënyrë të organizuar dhe të kontrolluar, duke siguruar shpërndarjen e pasurisë së debitorit sipas prioritetit ligjor. Ky proces mundëson që kreditorët të realizojnë pjesërisht apo tërësisht kërkesat e tyre ndaj debitorit, duke shmangur kaosin, vonesat dhe pasigurinë e procedurave individuale, gjyqësore e përmbarimore.

ii) Shpërndarje e drejtë dhe transparente: nëpërmjet administratorit të falimentimit, pasuria e debitorit shpërndahet në përputhje me rregullat e rendit të prioritetit ligjor, duke siguruar që kreditorët të kenë mundësinë të realizojnë kërkesat që kanë ndaj debitorit në mënyrë të drejtë, të parashikueshme dhe transparente.

iii) Mundësi për ristrukturimin e raportit me debitorin: në procedurë të riorganizimit, kreditorët kanë mundësinë të kontribuojnë në hartimin e planit të riorganizimit të debitorit. Përmes votës së tyre, kreditorët mund të ndikojnë në mënyrën se si do të ristrukturohen marrëdhëniet afariste me debitorin, duke siguruar në këtë mënyrë kthim më të lartë, ose edhe të plotë të kërkesës së tyre.

IX. KONKLUZION

Nëpërmjet këtij udhëzuesi u ofrua një pasqyrë e përgjithshme mbi kuptimin, kornizën ligjore, dhe rëndësinë praktike të procedurës e falimentimit për bizneset që përballen me vështirësi financiare, si dhe për bizneset të cilat kanë kërkesa të parealizuara ndaj kompanive në vështirësi financiare.

Me të kuptuar këto elemente të procedurës së falimentimit, kompanitë mund të navigojnë në mënyrë të suksesshme kompleksitetin e saj, duke krijuar kështu një ide për të drejtat, detyrimet dhe zgjedhjet që i presin në këtë proces. Përmes përshkrimit të procedurës së falimentimit dhe ofrimit të shembujve praktik, ky udhëzues synon të sqarojë përfitimet e ndjekjes së këtij procesi të strukturuar ligjor për të dyja palët e përfshira.

Po ashtu, nëpërmjet këtij udhëzuesi u synua të korrigjohen keqkuptimet e zakonshme që e shoqërojnë procesin e falimentimit dhe që të hedhet dritë mbi rëndësinë e tij për bizneset vendore.

Qoftë përmes riorganizimit për të rikthyer qëndrueshmërinë financiare, apo përmes likuidimit për të përmbushur detyrimet financiare, procedura e falimentimit garanton një ambient ligjor që mbrohet interesat e të gjitha palëve të përfshira, në këtë mënyrë, duke ofruar një bazë të sigurt dhe transparente për të trajtuar vështirësitë financiare dhe duke mundësuar një rritje të qëndrueshme të ekonomisë në përgjithësi.





VOKSHI & LATA

L A W F I R M

**Rr. "Holger Petersen", Objekti "Park Residence",
Hyrja 4, Kati 0, Numër 2,
Prishtinë, Kosovë.**

+383 44 55 66 70

Info@vokshilata.com

www.vokshilata.com